# ЗЕЛС
# BNJVL

# ГЛАСИЛО
# GAZETË

Декември 2021
Dhjetor 2021



## 2022

## СРЕЌНА НОВА ГОДИНА И БОЖИЌНИ ПРАЗНИЦИ
## GËZUAR VITIN E RI DHE FESTAT E KRISHTLINDJEVE

ЗЕЛС

ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

BNJVL

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Почитувани,

Пред нас е Новата 2022 година. Се надеваме дека ќе донесе многу позитивни работи за сите нас, пред сè добро здравје и успех во работењето, а за единиците на локалната самоуправа, реализација на новиот пакет реформи, особено во обезбедување на поголема финансиска стабилност.

Генералното собрание на ЗЕЛС ја одржа својата конститутивна седница овој месец, што е во согласност со Статутот на ЗЕЛС, односно не подоцна од три месеци по спроведувањето на локалните избори. Ова највисоко тело на ЗЕЛС го утврди својот состав за мандатот 2021-2025 година и исто така ги избра членовите и на другите тела на ЗЕЛС: на Управниот одбор, Комитетот на советите и на Надзорниот одбор на ЗЕЛС. На конститутивните седници, овие тела ги избраа своите раководства (претседател и двајца потпретседатели). Раководството на Управниот одбор на ЗЕЛС истовремено е и раководството на Заедницата. Па така, во следните четири години Данела Арсовска, градоначалничка на Град Скопје, ќе биде претседател на ЗЕЛС, а Висар Ганиу, градоначалник на Општина Чаир, и Перо Костадинов, градоначалник на Општина Валандово, ќе бидат двајцата потпретседатели на ЗЕЛС. Комитетот на советите при ЗЕЛС за претседател го избра Трајко Славески, претседател на Советот на Град Скопје, а негови заменици се: Сашка Крстевска-Павловска, претседател на Советот на Општина Старо Нагоричане и Илир Елези, претседател на Советот на Општина Боговиње. Во следниот период ќе бидат избрани и членовите на комисиите во ЗЕЛС, како и другите кандидати што ќе ја претставуваат ЗЕЛС во некои домашни и странски органи и институции. Во рамките на ЗЕЛС се утврдуваат и членовите на специјализираните мрежи, составени од професионалната општинска администрација.

За сите општински советници и за сите градоначалници, стручната служба на ЗЕЛС традиционално, по секој изборен циклус подготвува и издава „Прирачник, водич низ надлежностите за новоизбраните градоначалници и членовите на советите на општините“ од кој, бесплатен примерок ќе добијат сите општински советници и сите градоначалници. Публикувањето на Прирачникот беше обезбедено со техничка поддршка на Програмата за развој на Обединетите нации (УНДП) во рамките на проектот „Зајакнување на општински совети“.

Во декември, ЗЕЛС организираше и други активности, кои одат во насока на јакнење на капацитетите на општинската администрација. Исто така, ЗЕЛС во соработка со Министерството за транспорт и врски, отвори нов циклус за стекнување со лиценца за водење на постапка за отуѓување и давање под закуп на државно градежно земјиште, при што по реализираните обуки, како и по спроведениот теоретски и практичен дел од испитот, со оваа лиценца се стекнаа 44 кандидати од општинската администрација.

На сите градоначалници, советници и претставници на општинската администрација им ја честитам Новата 2022 година и им посакувам добро здравје и бериќет на сите полиња.

Со почит,

Душица Перишиќ,
извршен директор на ЗЕЛС

Të nderuar,

Para nesh është viti i ri 2022. Shpresojmë se do të sjellë shumë gjëra pozitive për të gjithë ne, mbi të gjitha shëndet dhe suksese në punën tonë, dhe për njësitë e vetëqeverisjes lokale, realizimi i paketës së re të reformave, veçanërisht në sigurimin e një stabiliteti më të madh financiar.

Kuvendi Gjeneral i BNJVL-së këtë muaj e mbajti seancën konstituive, e cila është në përputhje me Statutin e BNJVL-së, përkatësisht jo më vonë se tre muaj pas zgjedhjeve lokale. Ky organ më i lartë i BNJVL-së e përcaktoi përbërjen e tij për mandatin 2021-2025 dhe zgjodhi edhe anëtarët e organeve të tjera të BNJVL-së: Bordin drejtues, Komitetin e Këshillave dhe Bordin mbikëqyrës të BNJVL-së. Në seancat konstituive këto organe zgjodhën drejtuesit e tyre (kryetarin dhe dy nënkryetarët). Kryesia e Bordit Drejtues të BNJVL-së është njëkohësisht edhe kryesi e Bashkësisë. Kështu, në katër vitet e ardhshme, kryetarja e qytetit të Shkupit, Danella Arsovska do të jetë kryetare e BNJVL-së, ndërsa Visar Ganiu, kryetar i Komunës së Çairit dhe Pero Kostadinov, kryetar i Komunës së Vallandovës do të jenë dy nënkryetarë të BNJVL-së. Komiteti i Këshillave pranë BNJVL-së për kryetar zgjodhi Trajko Sllaveski, kryetar i Këshillit të Qytetit të Shkupit, ndërsa zëvendës të tij janë: Saska Krstevska-Pavlovska, kryetare e Këshillit të Komunës së Staro Nagoriçanit dhe Ilir Elezi, kryetar i Këshilli i Komunës së Bogovinës. Në periudhën e ardhshme do të zgjedhen anëtarët e komisioneve pranë BNJVL, si dhe kandidatët e tjerë që do ta përfaqësojnë BNJVL-në në disa organe dhe institucione vendore dhe të huaja. Në kuadër të BNJVL-së përcaktohen edhe anëtarët e rrjeteve të specializuara, të përbëra nga administrata profesionale komunale.

Për të gjithë këshilltarët komunalë dhe për të gjithë kryetarët e komunave, shërbimi profesional i BNJVL-së, tradicionalisht, pas çdo cikli zgjedhor përgatit dhe publikon “Doracak, udhëzues drejt kompetencave për kryetarët e sapozgjedhur dhe anëtarët e këshillave komunale» nga i cili për të gjithë kryetarët dhe këshilltarët komunal do të sigurohet nga një kopje. Publikimi i doracakut është siguruar me mbështetjen teknike të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në kuadër të projektit «Forcimi i këshillave komunale”.

Në dhjetor, BNJVL organizoi edhe aktivitete tjera, të cilat kanë për qëllim forcimin e kapaciteteve të administratës komunale. Gjithashtu, BNJVL në bashkëpunim me Ministrinë për Transport dhe Lidhje, hapi një cikël të ri për marrjen e licencës për kryerjen e procedurës për tjetërsimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore shtetërore, ku pas trajnimeve të realizuara, si dhe pjesës së realizuar teorike dhe praktike të provimin, me këtë licencë janë pajisur 44 kandidatë nga administrata komunale.

Të gjithë kryetarëve të komunave, këshilltarëve dhe përfaqësuesve të administratës komunale u uroj Vitin e Ri 2022 duke u dëshiruar shëndet dhe prosperitet në të gjitha fushat.

Me respekt,

Dushica Perishiq,
Drejtor ekzekutiv i BNJVL-së


**ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**
тел. +389 (0) 2 30 99 033, факс: +389 (0) 2 30 61 994
ул. Копенхагенска бр. 5, п.фах 32,
1000 Скопје, Република Северна Македонија
**Извршен директор на ЗЕЛС:**
Душица Перишиќ
**Заменик извршен директор на ЗЕЛС:**
Ардита Дема-Мехмети
**Подготвила:**
Весна Арсовска-Динковска
**Превод:** ЗЕЛС
**Лекторирал:** Валентина Великова
**Дизајн и подготовка и печатење:** Европа 92

**BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**
tel. +389 (0) 2 30 99 033, faks: +389 (0)2 30 61 994
rr. „ Kopenhagenska” nr. 5, F.P. 32,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
**Drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Dushica Perishiq
**Zëvendes drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Ardita Dema - Mehmeti
**Përgatiti:**
Vesna Arsovska - Dinkovska
**Përkthim:** BNJVL
**Lektoron:** Valentina Velikova
**Dizajnim dhe përgatitje shtyp:** Evropa 92

## РЕГИОНАЛНА КОНФЕРЕНЦИЈА - ПОЧЕТОК НА АКТИВНОСТИТЕ ОД НОВИОТ ПРОЕКТ ЗА ЕНЕРГЕТСКА ТРАНЗИЦИЈА ВО ЗАПАДЕН БАЛКАН И ТУРЦИЈА

Во рамките на проектот „ЕУ за енергетска транзиција: Пакт на градоначалници на Западен Балкан и Турција" на 24 ноември 2021 година беше одржана онлајн регионална конференција со која се означи почетокот на реализацијата на утврдените проектни активности. На овој настан учествуваа претставници од градови/општини, учесници во проектот од земјите од Западен Балкан, од Турција и од Европската Унија. Освен целите на проектот, на конференцијата беа презентирани примери за успешна климатска акција на ниво на градови, а за време на панел-дискусијата, градоначалниците од регионот ги разменија своите ставови за предизвиците со кои се соочуваат при осмислувањето и спроведувањето на ефективните климатски политики и разговараа за идните чекори за постигнување успешна енергетска транзиција на локално ниво.

Проектот во нашата земја го спроведува Заедницата на единиците на локалната самоуправа на РСМ - ЗЕЛС заедно со Германската развојна агенција (ГИЗ). Проектот е кофинансиран од Европската Унија и од Германското сојузно министерство за економска соработка и развој (BMZ), а во Западен Балкан го спроведува ГИЗ во рамките на Отворениот регионален фонд за Југоисточна Европа – енергија, транспорт и климатска заштита (ОРФ – ЕТЦ) и Централната агенција за управување со проекти (CPMA) во Турција.

Претставникот на Генералниот директорат на Европската комисија за соседска политика и преговори за проширување (DG NEAR), **Роберто Естељес Колом**, во својот воведен говор на конференцијата, истакна дека проширувањето на Пактот на градоначалниците на Западен Балкан и Турција е важна алатка за спроведување на Зелената агенда за Западен Балкан. Поддржана од лидерите на Западен Балкан на Самитот во Софија, на 10 ноември 2020 година, Зелената агенда е нова стратегија за раст за регионот, која претставува скок од традиционалниот економски модел на одржлива економија, во согласност со Европскиот зелен договор. Пактот на градоначалниците ќе го поддржи исполнувањето на целите на Зелената агенда за усогласување на регионот со амбицијата на ЕУ да ја направи Европа јаглеродно неутрален континент до 2050 година, цел што вклучува борба против загадувањето на воздухот, водата и почвата.

Во име на Германското друштво за меѓународна соработка (ГИЗ) говореше д-р **Наталија ел Хаге**, директор за Босна и Херцеговина и Црна Гора, која посочи дека во споредба со европскиот просек, земјите од Западен Балкан произведуваат десет пати поголемо количество $CO2$ потребно за генерирање ист бруто домашен производ. Во таа насока, во името на германската сојузна влада и мултилатералните партнери, (како што е ЕУ) ГИЗ обезбедува техничка поддршка и експертиза за

## KONFERENCË RAJONALE - FILLIMI I AKTIVITETEVE NGA PROJEKTI I RI PËR TRANZICIONIN ENERGJETIK NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQI

Në kuadër të projektit "BE për tranzicionin energjetik: Pakti i Kryetarëve të komunave nga Ballkani perëndimor dhe Turqia" më 24 nëntor 2021 u mbajt konferencë rajonale online e cila shënoi fillimin e zbatimit të aktiviteteve të identifikuara të projektit. Në këtë event morën pjesë përfaqësues të qyteteve/komunave, pjesëmarrëse në projekt nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, Turqia dhe Bashkimi Evropian. Krahas objektivave të projektit, në konferencë u prezantuan shembuj të veprimit të suksesshëm klimatik në nivel qyteti dhe gjatë panelit të diskutimit, kryetarët e komunave të rajonit shkëmbyen mendime mbi sfidat me të cilat përballen në hartimin dhe zbatimin e politikave efektive klimatike dhe diskutuan për hapat e ardhshëm për të arritur tranzicion të suksesshëm të energjisë në nivel lokal.

Projektin në vendin tonë e realizon Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale të RMV-së - BNJVL së bashku me Agjencinë Gjermane për zhvillim (GIZ). Projekti është i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), dhe në Ballkanin Perëndimor zbatohet nga GIZ në kuadër të Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - energjia, transporti dhe mbrojtja klimatike (ORF - ETC) dhe Agjencia Qendrore e Menaxhimit të Projekteve (CPMA) në Turqi.

Përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Komisionit Evropian për politikat e fqinjësisë dhe negociatat e zgjerimit (DG NEAR), **Roberto Estelles Colom**, në fjalën e tij hyrëse në konferencë, theksoi se zgjerimi i Paktit të kryetarëve të komunave të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë është një gjë e rëndësishme, si mjet për zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Mbështetur nga liderët e Ballkanit Perëndimor në Samitin e Sofjes më 10 nëntor 2020, Agjenda e Gjelbër është strategji e re e rritjes për rajonin, një kapërcim nga modeli tradicional ekonomik i një ekonomie të qëndrueshme, në përputhje me Marrëveshjen Evropiane të gjelbër. Pakti i kryetarëve të komunave do të mbështesë përmbushjen e Agjendës së gjelbër për përafrimin e rajonit me ambicien e BE-së për ta bërë Evropën një kontinent neutral ndaj karbonit deri në vitin 2050, një objektiv që përfshin luftimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës.

Duke folur në emër të Shoqatës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), Dr. **Natalia el Hage**, Drejtoreshë për Bosnjë-Hercegovinën dhe Malin e Zi, vuri në dukje se krahasuar me mesataren evropiane, vendet e Ballkanit Perëndimor prodhojnë dhjetëfishin e sasisë së $CO2$ të nevojshme për të gjeneruar të njëjtin bruto produkt vendor. Për këtë qëllim, në emër të Qeverisë Federale Gjermane dhe partnerëve shumëpalësh (si BE-ja), GIZ ofron mbështetje teknike dhe ekspertizë për autoritetet

локалните власти од Западен Балкан за справувањето со предизвиците на климатските промени и енергетската транзиција.

**„Пакт на градоначалниците за енергија и климатски промени“ - глобален сојуз на градови и општини за обезбедување на ниска емисија на јаглерод**

Целта на проектот е спроведување на енергетската транзиција и справување со климатските промени во Западен Балкан и Турција, преку зголемено прифаќање на иницијативата „Пакт на градоначалниците за енергија и климатски промени“ и поддршка на општинските власти да ги зајакнат нивните напори за намалување на емисијата на стакленичките гасови и зголемување на отпорноста на влијанијата од климатските промени. Пактот на градоначалниците за енергија и климатски промени е глобален сојуз на градови со заедничка долгорочна визија за поддршка на климатските активности и градење отпорни општества со ниска емисија на јаглерод.

**Советодавни услуги и стручна поддршка на две општини**

Специфичната цел на проектот е да се обезбеди поддршка за градовите во исполнувањето на нивните енергетски и климатски обврски, а една од клучните активности на овој проект е да се обезбедат советодавни услуги и стручна поддршка за две општини од РСМ. Во процесот на развој на акциски планови за енергетски и климатски одржлив развој (SECAP), тие ќе се обврзат да ги намалат емисиите на стакленички гасови за најмалку 40 проценти до 2030 година и да ја подобрат својата отпорност на влијанијата на климатските промени. Во рамките на проектот ќе се обезбеди поддршка за имплементација на инфраструктурните проекти од помал обем, со цел да се покаже како градовите можат да се справат со климатските промени и истовремено да ја подобрат благосостојбата на своите граѓани. Дополнително, проектот ќе овозможи унапредување на регионалната соработка во насока на обезбедување  долгорочна одржливост на проектот.

lokale në Ballkanin Perëndimor për të adresuar sfidat e ndryshimeve klimatike dhe tranzicionit energjetik.

**„Pakti i kryetarëve të komunave për energjinë dhe ndryshimet klimatike” – aleancë globale e qyteteve dhe komunave për të siguruar emetim të ulët të karbonit**

Qëllimi i projektit është të zbatojë tranzicionin energjetik dhe të trajtojë ndryshimet klimatike në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, duke përqafuar gjithnjë e më shumë nismën e “Paktit të Kryetarëve të komunave për energjinë dhe ndryshimet klimatike” dhe duke mbështetur autoritetet komunale për të rritur përpjekjet e tyre për të reduktuar emetimet e gazrave të qelqit dhe rritjes së rezistencës ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike. Pakti i kryetarëve për energjinë dhe ndryshimet klimatike është një aleancë globale e qyteteve me një vizion të përbashkët afatgjatë për të mbështetur veprimet klimatike dhe për të ndërtuar shoqëri rezistente me emetim të ulët të karbonit.

**Shërbime këshillimore dhe mbështetje profesionale për dy komuna**

Qëllimi specifik i projektit është të ofrojë mbështetje për qytetet në përmbushjen e detyrimeve të tyre energjetike dhe klimatike, dhe një nga aktivitetet kyçe të këtij projekti është ofrimi i shërbimeve këshillimore dhe mbështetjes profesionale për dy komuna në RMV. Në procesin e zhvillimit të Planeve të Veprimit të Qëndrueshëm për Energjinë dhe Klimën (SECAP), ata do të angazhohen për të reduktuar emetimet e gazrave të qelqit me të paktën 40 % deri në vitin 2030 dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë e tyre ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike. Projekti do të ofrojë mbështetje për zbatimin e projekteve të infrastrukturës me shkallë të vogël, në mënyrë që të tregojë sesi qytetet mund të përballen me ndryshimet klimatike dhe në të njëjtën kohë të përmirësojnë mirëqenien e qytetarëve të tyre. Gjithashtu, projekti do të mundësojë promovimin e bashkëpunimit rajonal për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë të projektit.






## СОЦИЈАЛНО МАПИРАЊЕ НА РАНЛИВИТЕ ЛИЦА - АЛАТКА ЗА КРЕИРАЊЕ НА ПОЛИТИКИ ЗАСНОВАНИ НА ДОКАЗИ

Темата на националната работилница што ја организираше ЗЕЛС на 25 ноември 2021, во хотелот „Александар Палас“ во Скопје, е „Социјално мапирање на ранливите лица - алатка за креирање на политики засновани на докази“. Работилницата претставуваше дел од активностите од проектот „Регионално учење за имплементација на Агендата 2030 во Југоисточна Европа“, што го спроведува ЗЕЛС во соработка со Мрежата на асоцијации на локалните власти од Југоисточна Европа (НАЛАС), а со поддршка на Германското друштво за меѓународна соработка (ГИЗ). Во пилот-фазата на проектот се вклучени три општини од нашата земја: Битола, Велес, Штип, а преку директна поддршка од ГИЗ е вклучена и Општина Ресен. Во следната фаза на проектот, алатката за социјално мапирање ќе биде применета во уште две општини: Струмица и Кочани.

Пред присутните претставници од општините вклучени во проектот, пред претставниците од соодветните министерства, народниот правобранител и експертите од ангажираните консултантски куќи, се обрати извршната директорка на ЗЕЛС, Душица Перишиќ. Таа ја нагласи полезноста што единиците на локалната самоуправа ќе ја имаат од примената на алатката за социјално мапирање и посочи дека вклучените општини во проектот ќе можат стекнатите добри примери од овој процес да им ги пренесат на своите колеги од другите општини. На работилницата се обратија и Милан Живковиќ, советник за труд и социјална политика на претседателот на Владата на РСМ; Мајкл Самец, тим лидер во ГИЗ и Келменд Зајази, извршен директор на НАЛАС, кои посочија дека социјалното мапирање обезбедува егзактни податоци за состојбите во општините што може да се користат за креирање на поквалитетни социјални политики, не само на локално туку и на централно ниво. По воведните обраќања, беше прикажано видео, снимено во Општина Битола, кое сведочеше за предизвиците со кои се соочуваат лицата со попречености, една од ранливите групи вклучени во самото социјално мапирање во општините.

## HARTA SOCIALE E PERSONAVE TË CËNUESHËM - VEGËL PËR KRIJIMIN E POLITIKAVE TË BAZUARA NË DËSHMI

Tema e punëtorisë nacionale të organizuar nga BNJVL më 25 nëntor 2021, në hotelin Aleksandar Palas në Shkup, është “Harta sociale e personave të cenueshëm – vegël për krijimin e politikave të bazuara në dëshmi”. Punëtoria ishte pjesë e aktiviteteve të projektit “Të mësuarit rajonal për zbatimin e Agjendës 2030 në Evropën Juglindore”, të cilin e zbaton BNJVL në bashkëpunim me Rrjetin e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS), me mbështetjen e Shoqërisë gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar (GIZ). Në fazën pilot të projektit janë përfshirë tri komuna nga vendi ynë: Manastiri, Velesi, Shtipi, ndërsa përmes mbështetjes direkte nga GIZ është përfshirë edhe Komuna e Resnjës. Në fazën tjetër të projektit, vegla e hartës sociale do të aplikohet në dy komuna të tjera: Strumicë dhe Koçan.

Drejtoresha ekzekutive e BNJVL-së, Dushica Perishiq, iu drejtua përfaqësuesve të pranishëm të komunave të përfshira në projekt, përfaqësuesve të ministrive përkatëse, Avokatit të Popullit dhe ekspertëve nga kompanitë e angazhuara konsulente. Ajo theksoi dobinë që do të kenë njësitë e vetëqeverisjes lokale nga aplikimi i veglës së hartës sociale dhe vuri në dukje se komunat e përfshira në projekt do të mund të bartin shembujt e mirë të fituar nga ky proces tek kolegët e tyre nga komunat tjera. Në seminar foli edhe Milan Zhivkoviq, Këshilltar për Punë dhe Politikë Sociale i Kryeministrit të RMV-së; Michael Samec, udhëheqës i ekipit në GIZ dhe Kelmend Zajazi, CEO i NALAS, i cili theksoi se harta sociale ofron të dhëna të sakta për situatën në komuna që mund të përdoren për të krijuar politika sociale më të mira, jo vetëm në nivel lokal, por edhe qendror. Pas fjalimeve hyrëse, u shfaq një video e regjistruar në Komunën e Manastirit, e cila dëshmoi për sfidat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara, një nga grupet e cenueshme të përfshira në hartën sociale nëpër komuna.

**Споделени искуства на општините од имплементирањето на податоците од социјалните мапирања**

Во рамките на првата панел-дискусија на работилницата, претставниците од општините ги споделија своите искуства од полезноста на добиените податоци од спроведените социјални мапирања во општината во процесот на креирање на натамошните социјални политики во општината. Тие посочија дека истите искуства ги искористиле за надградување на постојните локални стратешки и акциски документи од областа на социјалната заштита, каде најчесто воведе нови, дотогаш неутврдени социјални услуги на локално ниво. Исто така, клучните наоди ги интегрирале во рамките на останатите локални политики, а предвиделе и буџетски средства за спроведување на планираните мерки.

**Изнесени препораки релевантни за локално, но и за национално ниво**

Во рамките на втората панел-дискусија, ангажираните експерти, кои беа дел од спроведувањето на социјалното мапирање во секоја од општините, ги презентираа резултатите од спроведеното мапирање и дадоа соодветни препораки релевантни за локално, но и за национално ниво. Дел од препораките за локалните власти се однесуваа на потребата за интеграција на лицата со попреченост на пазарот на трудот преку обезбедување на соодветни обуки, со цел подобрување на нивниот социо-економски статус; потреба од обуки за персонална асистенција и нега за постарите лица и потреба од креирање на соодветни програми каде што акцентот ќе биде ставен на Ромките, жртви на насилство. Имплементацијата на овие препораки општините треба да ја реализираат во соработка со релевантните институции и здруженија на локално ниво. Притоа, беше нагласена потребата за размена на податоците од социјалното мапирање меѓу институциите; беше посочена и потребата од вертикална размена на податоци преку регионалните совети за социјална заштита, што се во процес на воспоставување. Унапредувањето и координацијата меѓу институциите на локално и на национално ниво, особено во областа на податоците за ранливите групи граѓани, исто така се дел од препораките.

**Shkëmbimi i përvojave të komunave nga zbatimi i të dhënave nga harta sociale**

Gjatë panelit të parë të punëtorisë, përfaqësuesit e komunave ndanë përvojat e tyre nga dobia e të dhënave të marra nga harta sociale e realizuar në komunë në procesin e krijimit të politikave të mëtejshme sociale në komunë. Ata theksuan se të njëjtat përvoja kanë shfrytëzuar për të përmirësuar dokumentet ekzistuese strategjike dhe të veprimit vendor në fushën e mbrojtjes sociale, ku shpesh kanë prezantuar shërbime të reja sociale, deri më tani të papërcaktuara në nivel lokal. Ata gjithashtu integruan gjetjet kryesore në politika të tjera vendore dhe siguruan fonde buxhetore për zbatimin e masave të planifikuara.

**U prezantuan rekomandime relevante për nivelin lokal por edhe atë nacional**

Gjatë panelit të dytë, ekspertët e angazhuar, të cilët ishin pjesë e zbatimit të hartës sociale në secilën nga komunat, prezantuan rezultatet e hartëzimit të zbatuar dhe dhanë rekomandimet e duhura relevante si për nivelin lokal ashtu edhe për atë kombëtar. Disa nga rekomandimet për autoritetet vendore i referoheshin nevojës për integrimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës duke ofruar trajnime të përshtatshme, me qëllim përmirësimin e statusit të tyre social-ekonomik; nevoja për trajnime në asistencë dhe përkujdesje personale për të moshuarit dhe nevoja për krijimin e programeve të përshtatshme ku theksi do të jetë tek gratë rome, viktima të dhunës. Zbatimi i këtyre rekomandimeve duhet të realizohet nga komunat në bashkëpunim me institucionet dhe shoqatat përkatëse në nivel lokal. Me këtë u theksua nevoja e shkëmbimit të të dhënave nga harta sociale ndërmjet institucioneve. Gjithashtu u theksua nevoja e shkëmbimit vertikal të të dhënave përmes këshillave të qarqeve për mbrojtje sociale, të cilat janë në proces themelimi. Përmirësimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve në nivel lokal dhe qëndror, veçanërisht në fushën e të dhënave për grupet e cënueshme të qytetarëve, janë gjithashtu pjesë e rekomandimeve.



## ИНКОРПОРИРАЊЕ НА ИСТАНБУЛСКАТА КОНВЕНЦИЈА ВО ЛОКАЛНИТЕ ПОЛИТИКИ – ОБУКА ВО РАМКИТЕ НА КАМПАЊАТА „16 ДЕНА АКТИВИЗАМ ПРОТИВ РОДОВО БАЗИРАНОТО НАСИЛСТВО“

„Локализација на Конвенцијата на Советот на Европа за спречување и борба против насилството врз жените и семејното насилство – Истанбулска конвенција: креирање на мерки во рамките на локалните програми за родова еднаквост и социјална заштита“ беше темата на обуката што ја организираше ЗЕЛС, на 10 декември 2021 година во просториите на ЗЕЛС тренинг центарот. Обуката беше организирана во рамките на кампањата „16 дена активизам против родово базираното насилство“. Поканетите претставници од општините (лицата одговорни за родова еднаквост и социјални заштита) имаа можност да ги унапредат своите знаења за Истанбулската конвенција, како најсеопфатен документ што ги воспоставува правно обврзувачките стандарди за превенција и спречување на насилството врз жените и семејното насилство, како и да дискутираат за националните закони и документи поврзани со спроведувањето на оваа меѓународна конвенција.

Фокусот беше ставен на учеството на општините при имплементирање на Конвенцијата, односно креирање на интегрирани и координирани локални политики за превенција на насилството врз жените и семејното насилство, како и воспоставување и поддршка на специјализирани услуги за жените жртви на насилство. Конвенцијата на Советот на Европа за спречување и борба против насилството врз жените и семејното насилство (Истанбулска конвенција) бара лесно достапни и пристапни сервиси за жените жртви на насилство и семејно насилство. Се дискутираше и за Законот за спречување и заштита од насилство врз жените и семејното насилство, за Националниот акциски план за спроведување на Истанбулската конвенција и за Законот за социјална заштита, при што акцентот беше ставен на активностите на

## PËRFSHIRJA E KONVENTËS SË STAMBOLLIT NË POLITIKËN LOKALE - TRAJNIM NË KUADËR TË FUSHATËS "16 DITË AKTIVIZËM KUNDËR DHUNËS NË BAZË GJINORE"

"Lokalizimi i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - Konventa e Stambollit: Krijimi i masave në kuadër të programeve lokale për barazi gjinore dhe mbrojtje sociale" ishte tema e trajnimit të organizuar nga BNJVL, më 10 dhjetor 2021 në hapësirat e qendrës së trajnimit të BNJVL-së. Trajnimi u organizua në kuadër të fushatës “16 ditë aktivizëm kundër dhunës në bazë gjinore”. Përfaqësuesit e ftuar nga komunat (personat përgjegjës për barazi gjinore dhe mbrojtje sociale) patën mundësinë të avancojnë njohuritë e tyre për Konventën e Stambollit, si dokument më gjithëpërfshirës që vendos standarde ligjërisht të detyrueshme për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe për të diskutuar për ligjet dhe instrumentet që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj konvente ndërkombëtare.

Në fokus ishte pjesëmarrja e komunave në zbatimin e Konventës, gjegjësisht krijimi i politikave lokale të integruara dhe të koordinuara për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe zhvillimi dhe mbështetja e shërbimeve të specializuara për gratë viktima të dhunës. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) kërkon shërbime lehtësisht qasëse për gratë viktima të dhunës dhe dhunës në familje. U diskutua edhe për Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunën në familje, Planin kombëtar të veprimit për zbatimin e Konventës së Stambollit dhe Ligjin për mbrojtjen sociale, me theks në aktivitetet e komunave për parandalimin dhe zhvillimin e shërbimeve sociale për viktimat e dhunës në familje. Këto dokumente ofrojnë një bazë solide ligjore për përfshirjen e komunave në krijimin dhe mbështetjen e shërbimeve për viktimat e dhunës, të








општините за превенција и воспоставување на социјални услуги за жртвите на семејното насилство. Овие документи обезбедуваат солидна правна основа за вклучување на општините за воспоставување и поддршка на сервиси за жртвите на насилство, што ќе претставува исполнување на дел од стандардите на Истанбулската конвенција, за обезбедување на соодветна заштита на жртвите и промовирање на нула толеранција кон насилството. Вклученоста на локалната самоуправа е потребна за воспоставување на услугите за специјализирана поддршка: засолништа, телефонски линии за помош, услуги за жртвите на сексуалното насилство, правна поддршка, советодавни центри и поддршка за децата сведоци.

cilat do të përmbushin disa nga standardet e Konventës së Stambollit, për sigurimin e mbrojtjes adekuate të viktimave dhe promovimin e tolerancës zero ndaj dhunës. Përfshirja e pushtetit vendor është e nevojshme për krijimin e shërbimeve të specializuara mbështetëse: strehimore, linja ndihmëse, shërbime për viktimat e dhunës seksuale, mbështetje ligjore, qendra këshillimi dhe mbështetje për fëmijët dëshmitarë.

dhënave përmes këshillave të qarqeve për mbrojtje sociale, të cilat janë në proces themelimi. Përmirësimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve në nivel lokal dhe qëndror, veçanërisht në fushën e të dhënave për grupet e cënueshme të qytetarëve, janë gjithashtu pjesë e rekomandimeve.

## ВКУПНО 44 КАНДИДАТИ СЕ СТЕКНАА СО ЛИЦЕНЦА ЗА ВОДЕЊЕ НА ПОСТАПКА ЗА ОТУЃУВАЊЕ И ДАВАЊЕ ПОД ЗАКУП НА ДРЖАВНО ГРАДЕЖНО ЗЕМЈИШТЕ

ЗЕЛС во соработка со Министерството за транспорт и врски, во текот на ноември –декември 2021 година, за претставниците од локалната власт отвори нов циклус за стекнување со лиценца за водење на постапка за отуѓување и давање под закуп на државно градежно земјиште. Оваа надлежност во целост е префрлена на единиците на локалната самоуправа, односно сите ЕЛС имаат право да управуваат со државното градежно земјиште, доколку ги исполниле законски утврдените услови. Еден од тие услови е и обврската општината да има соодветен број на лиценцирани вработени кои ќе ја водат постапката за отуѓување и давање под закуп на ова земјиште.

По објавувањето на јавниот оглас од страна на Комисијата за следење на процесот на организирање и спроведување на обука и спроведување на испит, во ЗЕЛС се пријавија 55 кандидати од редот на раководните или стручни административни службеници од соодветната област. Стручната служба на ЗЕЛС, по извршената проверка за исполнетост на условите за кандидатите, ги информира пријавените за термините за следење на почетната обука. Обуката беше организирана на 23 ноември, 2021 година, преку електронската платформа за комуникации Зум (ZOOM). Само оние кандидати што ја следеа почетната обука, како и кандидатите од февруарската сесија имаа можност да го полагаат теоретскиот, а потоа и практичниот дел од испитот што се

## GJITHSEJ 44 KANDIDATË U PAJISËN ME LICENCË PËR UDHËHEQJEN E PROCEDURËS PËR TJETËRSIMIN DHE DHËNIEN ME QIRA TË TOKËS NDËRTIMORE SHTETËRORE

BNJVL në bashkëpunim me Ministrinë për Transport dhe Lidhje, në periudhën nëntor-dhjetor 2021, hapi cikël të ri për përfaqësuesit e pushtetit lokal për marrjen e licencës për zbatimin e procedurës për tjetërsimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore shtetërore. Kjo kompetencë i bartet plotësisht njësive të vetëqeverisjes lokale, përkatësisht të gjitha NJVL-të kanë të drejtë të menaxhojnë tokën ndërtimore shtetërore, nëse i kanë plotësuar kushtet e përcaktuara me ligj. Një nga ato kushte është detyrimi i komunës që të ketë numër adekuat të punëtorëve të licencuar të cilët do të udhëheqin procedurën për tjetërsimin dhe dhënien me qira të kësaj toke.

Pas shpalljes publike nga Komisioni për monitorim të procesit të organizimit dhe mbajtjes së trajnimeve dhe mbajtjes së provimit, në BNJVL aplikuan 55 kandidatë nga radhët e zyrtarëve menaxherialë apo profesionalë administrativ nga fusha përkatëse. Shërbimi profesional i BNJVL-së, pas kontrollit për plotësimin e kushteve për kandidatët, i njofton aplikantët për kushtet për ndjekjen e trajnimit fillestar. Trajnimi u organizua më 23 nëntor 2021, përmes platformës së komunikimit elektronik ZOOM (ZOOM). Vetëm ata kandidatë që ndoqën trajnimin fillestar, si dhe kandidatët e sesionit të shkurtit patën mundësinë t'i nënshtrohen provimit për pjesën teorike dhe më pas atë praktike të provimit, që u mbajt në Qendrën e Provimeve



одржа во Испитниот центар на Европскиот универзитет, на 20 и на 24 декември 2021 година.

Во овој испитен циклус и теоретскиот и практичниот испит го положија вкупно 44 кандидати кои се стекнаа со овластување за водење постапка за отуѓување и давање под закуп на градежно земјиште.

На 30 декември 2021 година, обезбедени се два дополнителни термина за полагање, од кои во 10:40 часот почнува полагањето за теоретскиот дел, а во 12:00 часот ќе се реализира полагањето на практичниот дел.

Полагањето се спроведува електронски и резултатите се објавуваат на веб- страницата на ЗЕЛС, (www.zels.org.mk) веднаш по завршувањето на испитот. Испитот за стекнување со овластување се состои од два дела: прв, теоретски дел и втор дел, практичен пример. Полагањето на теоретскиот дел од испитот е во временски период од еден час, кога кандидатите одговараат на прашања што се однесуваат на постојната законска регулатива од областа на урбанизмот, градежното земјиште, постапките за експропријација, како и на користењето на софтверската апликација www.gradezno-zemjiste.mk. ЗЕЛС го одржува, управува, користи и го надградува овој информациски систем и истовремено им дава континуирана поддршка на општините при неговото користење. Преку www.gradezno-zemjiste.mk се спроведуваат сите постапки за отуѓување и давање под закуп на државно градежно земјиште, по пат на јавно наддавање и по пат на непосредна спогодба, утврдени во Законот за градежно земјиште. Практичниот дел од испитот претставува студија на случај.

pranë Universitetit Europian, më datën 20 dhe 24 dhjetor 2021.

Në këtë cikël provimi, provimin teorik dhe praktik e kanë dhënë gjithsej 44 kandidatë të cilët kanë fituar autorizimin për zhvillimin e procedurës për tjetërsimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore.

Më datë 30.12.2021 janë mundësuar dy afate shtesë për dhënien e provimit, nga të cilat provimi për pjesën teorike që fillon në ora 10:40, kurse provimi për pjesën praktike do të realizohet në orën 12:00.

Provimi zhvillohet në mënyrë elektronike dhe rezultatet publikohen në ueb faqen e BNJVL-së (www.zels.org.mk) menjëherë pas provimit. Provimi për autorizim përbëhet nga dy pjesë: e para, pjesa teorike dhe pjesa e dytë, me shembull praktik. Dhënia e pjesës teorike të provimit është në një periudhë prej një ore, kur kandidatët u përgjigjen pyetjeve që lidhen me legjislacionin ekzistues në fushën e urbanizmit, tokës ndërtimore, procedurave të shpronësimit, si dhe përdorimin e aplikacionit softuerik www.gradezno-zemjiste.mk. BNJVL-ja mirëmban, menaxhon, përdor dhe avancon këtë sistem informatik dhe në të njëjtën kohë u ofron mbështetje të vazhdueshme komunave në shfrytëzimin e tij. Përmes www.gradezno-zemjiste.mk zbatohen të gjitha procedurat për tjetërsimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore shtetërore, me ankand publik dhe me marrëveshje të drejtpërdrejtë, të përcaktuara në Ligjin për tokë ndërtimore. Pjesa praktike e provimit zhvillohet përmes një rasti, shembulli studimor.



## „ПРИРАЧНИК, ВОДИЧ НИЗ НАДЛЕЖНОСТИТЕ ЗА НОВОИЗБРАНИТЕ ГРАДОНАЧАЛНИЦИ И ЧЛЕНОВИТЕ НА СОВЕТИТЕ НА ОПШТИНИТЕ“

Стручната служба на ЗЕЛС го подготви петтото, ревидирано издание на „Прирачник, водич низ надлежностите за новоизбраните градоначалници и членовите на советите на општините“. Публикувањето на Прирачникот беше обезбедено со техничка поддршка на Програмата за развој на Обединетите нации (УНДП) во рамките на проектот „Зајакнување на општински совети“. Секој градоначалник и секој член на општинските совети ќе добие по еден бесплатен примерок од Прирачникот, којшто треба да им послужи како квалитетно и корисно четиво што ќе им биде секогаш при рака и од кое ќе можат да ги црпат потребните информации при донесувањето на важните одлуки од локално значење. Прирачникот ќе им биде од особена полза на локалните функционери кои за прв пат се соочуваат со извршувањето на локалните надлежности.

Преку Прирачникот, новоизбраните општински советници и градоначалници ќе се запознаат со целокупниот процес на децентрализација во земјата, со структурата на општината, со префрлените надлежности, како и со законите и со законските одредби за нивно спроведување. Финансирањето на општината, донесувањето на буџетот, развојот на локалната економија, просторното и урбанистичкото планирање, комуналните услуги, руралниот развој, образованието и заштитата на животната средина се, исто така, важни надлежности на локалната власт и се детално разработени. Од не помало значење за општините се и активностите во градењето на е-општина, воспоставувањето европски стандарди на услугите кон граѓаните, развивањето на транспарентното работење и информирање на јавноста, градењето на добрите релации со граѓанските организации и создавањето на општина според европски модел, па поради тоа и за овие теми е одвоено соодветно место во ова издание.

Прирачникот претставува и основа за натамошно унапредување на заедничките напори во развивањето на локалната самоуправа во нашата земја и ќе придонесе во напорите за обезбедување на модерни европски општини во кои граѓаните ќе добиваат квалитетни услуги и ќе имаат подобри услови за живот. Прирачникот е поставен и веб-страницата на ЗЕЛС zels.org.mk.




## "DORACAK, UDHËZUES DREJT KOMPETENCAVE TË KRYETARËVE TË SAPOZGJEDHUR TË KOMUNAVE DHE ANËTARËT E KËSHILLAVE KOMUNAL"

Shërbimi profesional i BNJVL-së ka përgatitur botimin e pestë, të korrigjuar të "Doracakut, udhëzues drejt kompetencave për kryetarët e sapozgjedhur të komunave dhe anëtarët e këshillave komunale". Publikimi i doracakut është siguruar me mbështetjen teknike të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në kuadër të projektit "Forcimi i Këshillave Komunale". Çdo kryetar komune dhe çdo anëtar i këshillit komunal do të marrë një kopje falas të doracakut, i cili duhet të shërbejë si një rrëfyes cilësor dhe i dobishëm që do të jetë gjithmonë pranë dhe nga i cili mund të nxjerrin informacionin e nevojshëm kur marrin vendime të rëndësishme me rëndësi lokale. Nga doracaku do të kenë dobi të veçantë sidomos zyrtarët lokalë të cilët po përballen me ushtrimin e kompetencave vendore për herë të parë.

Nëpërmjet doracakut, këshilltarët dhe kryetarët e komunave të sapozgjedhur do të njihen me procesin e decentralizimit në vend, me strukturën e komunave, me kompetencat e bartura, si dhe me ligjet dhe dispozitat ligjore për zbatimin e tyre. Financimi i komunës, miratimi i buxhetit, zhvillimi ekonomik lokal, planifikimi hapësinor dhe urbanistik, shërbimet komunale, zhvillimi rural, arsimi dhe mbrojtja e mjedisit janë gjithashtu kompetenca të rëndësishme të pushtetit lokal dhe janë shtjelluar në detaje. Jo më pak rëndësi për komunat janë edhe aktivitetet në ndërtimi e komunave elektronike, vendosjen e standardeve evropiane të shërbimeve ndaj qytetarëve, zhvillimin e operacioneve transparente dhe informimin e publikut, ndërtimin e marrëdhënieve të mira me organizatat e shoqërisë civile dhe krijimin e komunave sipas modelit evropian, që për këto tema është ndarë vend i veçantë në këtë botim.

Manuali është gjithashtu bazë për avancimin e mëtutjeshëm të përpjekjeve të përbashkëta në zhvillimin e vetëqeverisjes lokale në vendin tonë dhe do të kontribuojë në përpjekjet për të siguruar ngritje në komuna moderne evropiane në të cilat qytetarët do të marrin shërbime cilësore dhe do të kenë kushte më të mira jetese. Manuali mund të zbritni nga ueb faqja e BNJVL-së zels.org.mk.





## УТВРДЕН СОСТАВОТ НА СИТЕ ТЕЛА НА ЗЕЛС НА КОНСТИТУТИВНАТА СЕДНИЦА НА ГЕНЕРАЛНОТО СОБРАНИЕ НА ЗАЕДНИЦАТА

Новиот состав на Генералното собрание на ЗЕЛС, во согласност со Статутот, најдоцна во рок од три месеци од спроведувањето на локалните избори ја одржува конститутивната седница. Оваа одредба беше запазена во целост и Генералното собрание својата прва седница ја одржа на 22 декември 2021 година, во хотелот „Double Tree by Hilton", во Скопје. Ова највисоко тело на ЗЕЛС брои вкупно 90 делегати, од кои, според Статутот на ЗЕЛС, градоначалниците по функција се членови на ова тело, а во редот на делегати влегуваат и деветте членови на Комитетот на советите. На седницата беа присутни 77 делегати. Во ЗЕЛС членуваат сите 80 општини и Град Скопје како посебна единица на локалната самоуправа.

По изборот на соодветните комисии за утврдување и запазување на регуларноста на постапките (работно претседателство; верификациска и кандидатска комисија), а во согласност со утврдениот дневен ред, се пристапи кон гласање на предлозите за состав на другите тела на ЗЕЛС: Управниот одбор на ЗЕЛС, Комитетот на советите и Надзорниот одбор на ЗЕЛС.

## NË SEANCËN KONSTITUIVE TË KUVENDIT GJENERAL TË BASHKËSISË U PËRCAKTUA STRUKTURA E TË GJITHA TRUPAVE TË BNJVL-SË

Përbërja e re e Kuvendit Gjeneral të BNJVL-së, konform Statutit, më së voni në afat prej tre muajsh nga zbatimi i zgjedhjeve lokale mban seancën konstituive. Kjo dispozitë u morr parasysh në tërësi dhe Kuvendi Gjeneral seancën e tij të parë e mbajti më 22 dhjetor, 2021 në hotelin ,, DoubleTree by Hilton", në Shkup. Ky organ më i lartë i BNJVL-së ka gjithsej 90 delegatë, prej të cilëve, sipas Statutit të BNJVL-së, kryetarët e komunave janë anëtarë me funksion në këtë trup, ndërsa në listën e delegatëve janë nëntë anëtarët e Komitetit të Këshillave. Në seancë ishin të pranishëm 77 delegatë. Në BNJVL anëtare janë të gjitha 80 komunat dhe Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale.

Pas zgjedhjes së komisioneve përkatëse për përcaktimin dhe respektimin e rregullsisë së procedurave (kryesia punuese, komisioni verifikues dhe komisioni kandidues) ndërsa në përputhje me rendin e ditës të përcaktuar, u votuan propozimet për përbërjen e organeve tjera të BNJVL-së: Bordi drejtues i BNJVL-së, Komiteti i këshillave dhe Bordi mbikëqyrës i BNJVL-së.











**Избрани членовите на Комитетот на советите при ЗЕЛС**

Делегатите на Генералното собрание едногласно го прифатија предлогот на Кандидатската комисија за членови на Комитетот на Советите на ЗЕЛС. Комитетот на советите е составен од 9 члена од кои по еден претставник од 8-те плански региони во земјата и еден член на Советот на Град Скопје, кој според Статутот на ЗЕЛС има свој член во Комитетот на советите. Па така, во следниот период членови на **КОМИТЕТОТ НА СОВЕТИТЕ ПРИ ЗЕЛС** се претседателите на општинските совети:

1. **ТРАЈКО СЛАВЕСКИ**, ОД ГРАД СКОПЈЕ
2. **САШКА КРСТЕВСКА-ПАВЛОВСКА**, ОД ОПШТИНА СТАРО НАГОРИЧАНЕ, ПРЕТСТАВНИК ОД СЕВЕРОИСТОЧНИОТ ПЛАНСКИ РЕГИОН
3. **ИЛИР ЕЛЕЗИ**, ОД ОПШТИНА БОГОВИЊЕ, ПРЕТСТАВНИК ОД ПОЛОШКИОТ ПЛАНСКИ РЕГИОН
4. **САШО ДОНЕВ**, ОД ОПШТИНА ОХРИД, ПРЕТСТАВНИК ОД ЈУГОЗАПАДНИОТ ПЛАНСКИ РЕГИОН
5. **МОНИКА РИСТЕСКА**, ОД ОПШТИНА РАДОВИШ, ПРЕТСТАВНИК ОД ЈУГОИСТОЧНИОТ ПЛАНСКИ РЕГИОН
6. **ГАБРИЕЛА ИЛИЕВСКА**, ОД ОПШТИНА БИТОЛА, ПРЕТСТАВНИК ОД ПЕЛАГОНИСКИОТ ПЛАНСКИ РЕГИОН
7. **ИВАН ЖИВКОВСКИ**, ОД ОПШТИНА КИСЕЛА ВОДА, ПРЕТСТАВНИК ОД СКОПСКИОТ ПЛАНСКИ РЕГИОН
8. **ЗОРАН ЉУТКОВ**, ОД ОПШТИНА ВЕЛЕС, ПРЕТСТАВНИК ОД ВАРДАРСКИОТ ПЛАНСКИ РЕГИОН
9. **ГОЦЕ ПОПОВ**, ОД ОПШТИНА ДЕЛЧЕВО, ПРЕТСТАВНИК ОД ИСТОЧНИОТ ПЛАНСКИ РЕГИОН.













## U zgjodhën anëtarët e Komitetit të këshillave në kuadër të BNJVL-së

Delegatët e Kuvendit Gjeneral unanimisht pranuan propozimin e Komisionit kandidues për anëtarë të Komitetit të Këshillave të BNJVL-së. Komiteti i këshillave përbëhet prej 9 anëtarëve nga të cilët nga një përfaqësues të 8 rajoneve planifikuese në vend dhe një anëtar i Këshillit të Qytetit të Shkupit, i cili në bazë të Statutit të BNJVL-së ka anëtarin e tij në Komitetin e këshillave. Kështu, në periudhën e ardhshme anëtarët e KOMITETIT TË KËSHILLAVE NË KUADËR TË BNJVL-së janë kryetarët e këshillave komunale:

1. **TRAJKO SLLAVESKI**, NGA QYTETI I SHKUPIT
2. **SASHKA KËRSTEVSKA PAVLLOVSKA**, NGA KOMUNA STARO NAGORIÇANE, PËRFAQËSUESE NGA RAJONI VERILINDOR
3. **ILIR ELEZI**, NGA KOMUNA E BOGOVINËS, PËRFAQËSUES NGA RAJONI I POLLOGUT
4. **SASHO DONEV**, NGA KOMUNA E OHRIT, PËRFAQËSUES NGA RAJONI JUGPERËNDIMOR
